



Datë: 16.01.2026
Numër Protokolli: 186/2026

A.nr.1778/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Hava Fekaj, Zyrtare e Lartë për Inspektim Administrativ në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1778/2025, të datës 09.10.2025 të parashtruar nga ankuesit A.R-Z, A.H, A.B, G.K, V.J, G.Z, V.G, L.G, K.K, P.Th, R.R-A, L.P-K, A.K, K.M, M.A, M.T-A, A.A-S, S.Xh, G.N, M.M, Sh. A dhe S.Ll , të përfaqësuar nga ankuesja G.K, kundër Komisionit për Kushtet e Tregut të Punës/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.01.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1778/2025, e datës 09.10.2025, e parashtruar nga ankuesit: G.K,A.R-Z, A.H, A.B, G.K, V.J, G.Z, V.G, L.G, K.K, P.Th, R.R-A, L.P-K, A.K, K.M, M.A, M.T-A, A.A-S, S.Xh, G.N, M.M, Sh. A dhe S.Ll, ashtu që, **detyrohet** Komisioni për Kushte të Tregut të Punës në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të shqyrtoj dhe të nxjerrë akt administrativ lidhur me Kërkesën me numër protokolli 05-3903 të datës 22.05.2025, të Zv. Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

Ar sy e t i m

Nëpunësit civil, A.R-Z, A.H, A.B, G.K, V.J, G.Z, V.G, L.G, K.K, P.Th, R.R-A, L.P-K, A.K, K.M, M.A, M.T-A, A.A-S, S.Xh, G.N, M.M, Sh. A dhe S.Ll , (në tekstin e mëtejshme referuar: ankuesit), të punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë, me datë 09.10.2025 kanë parashtruar ankesë me numër protokollit 6691/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Komisionit për Kushtet e Tregut të Punës, në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, në raport me kërkesën me numër protokollit 05-3903 të datës 22.05.2025, të Zv. Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë, për miratimin e Shtesave për Kushtet e Tregut të Punës në vlerën financiare prej 250 Euro, për ankuesit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Kolegji i Këshillit) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 20.10.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Shëndetësisë, ndërsa me datë 23.10.2025 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës. Rrjedhimisht, Këshilli ka kërkuar prova shtesë edhe nga Komisioni për Kushtet e Tregut të Punës, në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa, ky i fundit me datë 21.11.2025 ka ofruar përgjigje.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e ankuesve, është e bazuar, dhe se ekziston baza ligjore që të detyrohet Komisioni për Kushtet e Tregut të Punës, në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, të shqyrtoj dhe të nxjerrë akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi, lidhur me Kërkesën me numër protokollit 05-3903 të datës 22.05.2025, të Zv. Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë, **sepse:** Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesit janë të punësuar në pozitat e punës **Inspektor Shëndetësor** pranë Ministrisë së Shëndetësisë.

Tutje, Ministri i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve përmes Vendimit Nr.36/2023 të datës 30.08.2023, ka aprovuar rekomandimin e Komisionit për Kushte të Tregut të Punës, për shtesa për kushte të tregut të punës, për profesionistët shëndetësor të punësuar në administratën e shërbimit civil të Ministrisë së Shëndetësisë, në shumën e shtesës prej dyqind e pesëdhjetë (250) euro në muaj, gjegjësisht për 45 nëpunës civil të kësaj Ministrie, ku në mesin e tyre ka përfshirë edhe Inspektorët Shëndetësor.

Ankuesit, kanë parashtruar kërkesë të përbashkët tek Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore pranë organit përkatës të punësimit, përmes të cilës shkresë kanë kërkuar plotësimin e Vendimit Nr.36/2023 të datës 30.08.2024 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për realizimin e shtesës për kushte të tregut të punës në vlerën financiare prej 250 Euro, për profesionistët shëndetësorë të punësuar në administratën e shërbimit civil të Ministrisë së Shëndetësisë, mirëpo të njëjtit nuk kishin pranuar përgjigje kundrejt kërkesës së tyre, ashtu që më datë 11.11.2024 kanë parashtruar ankesë, kundër heshtjes administrative në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës dhe në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, meqenëse ishte konstatuar se lidhur me kërkesën e ankuesve të datës 29.07.2024 institucioni nuk kishte nxjerr akt administrativ, lënda ishte kthyer në detyrim tek Ministria e Shëndetësisë, gjegjësisht përmes Vendimit A.nr.1708/2024 të datës 26.12.2024 ishte detyruar Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore të shqyrtoj kërkesën e ankuesve të datës 02.08.2024 dhe të nxjerrë akt administrativ në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Ndërsa, Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, më datë 13.01.2025 ka nxjerrë përgjigjen në kërkesë me numër protokolli 05-160, përmes së cilës ka theksuar se, citoj: *“Sekretari i Përgjithshëm, në fillim të vitit 2024 ka formuar një Grup punues, ad hoc, për shqyrtimin dhe analizimin e situatës lidhur me shtesat në pagë për nëpunësit civil në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë. Grupi punues, pas analizës së situatës, ka ardhur me një përfundim dhe ka rekomanduar se: Inspektorët Shëndetësor dhe Farmaceutik të përjashtohen nga lista e kuadrove deficitare për arsye, si në vijim: 1. Inspektorët Shëndetësor dhe Farmaceutik kanë koeficient 7.4, i barasvlershëm me koeficientin e Mjekut të Përgjithshëm në Sistemin Shëndetësor; për dallim nga Zyrtarët e lartë në Administratën Qendrore që ka koeficient 5.75; dhe 2. Për arsye se në Inspektoratin Shëndetësor dhe Farmaceutik ka profile tjera të shkollimit të cilat janë përjashtuar nga e drejta e kësaj shtese dhe mos të ketë diskriminim për pozitën/punën e njëjtë dikush të përfitojë shtesë dhe dikush jo. Lidhur me Inspektoratet, Grupi përgjegjës ka rekomanduar që të iniciohet kërkesë për “shtesë për rrezikshmëri në punë”, e cila parashihet me legjislacionin në fuqi, ku do të përfshiheshin të gjithë inspektorët pa dallim. Sipas Informacioneve që posedojmë, menaxhmenti i Ministrisë është duke e trajtuar çështjen dhe do të merret një qëndrim lidhur me procedurat e mëtejme”*

Ankuesit, e pa kënaqur me përgjigjen e lartë theksuar kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se me anë të kësaj përgjigjes nuk është shqyrtuar fare kërkesa e tyre për ndryshim dhe plotësim të listës së të punësuarve të cilët plotësojnë kriteret, bazuar në Nenin 10 paragrafin 2 të Rregullores Nr.02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës, duke theksuar ndër të tjera që organi i punësimit nuk ka adresuar këtë informim, dhe se duke mos u përditësuar lista dhe duke mos u kompensuar shtesat në fjalë janë duke u shkelur parimet themelore të Ligjit për Paga, përkatësisht i parimi barazisë dhe mos-diskriminimit.

Këshilli me Vendimin A.nr.151/2025 të datës 25.04.2025, kishte aprovuar ankesën e ankuesve, duke obliguar Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, ashtu që rastin e ankuesve t'a dërgoj për shqyrtim tek Komisioni për Kushte të Tregut të Punës.

Në zbatim të vendimit të lartë theksuar, Zv. Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, më datë 22.05.2025 ka përcjell kërkesën me numër protokolli 05-3903, tek Zv. Ministri i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve/ Komisioni për Kushte të Tregut të Punës, për miratimin e Shtesave për Kushtet e Tregut të Punës në vlerën financiare prej 250 Euro, për ankuesit dhe Inspektorët Farmaceutik, duke bashkangjitur listën me gjithsejtë 33 nëpunës.

Ankuesit, me datë 14.08.2025 kishin parashtruar ankesë në Këshill, kundër heshtjes administrative të Komisionit për Kushtet e Tregut të Punës/Ministria e Financave, Punës, me pretendimin ankimor për plotësimin e listës të nëpunësve civil që përfitojnë shtesën e kushteve të tregut të punës, duke theksuar ndër të tjera se duke mos u përditësuar lista dhe duke mos u kompensuar shtesat në fjalë janë duke u shkelur parimet themelore të Ligjit për Paga, përkatësisht parimi barazisë dhe mos-diskriminimit, si rrjedhojë kanë kërkuar kompensimin retroaktiv të kësaj shtese dhe vendosjen që edhe në të ardhmen e njëjta t'iu ekzekutohet ankuesve.

Këshilli, përmes Vendimit A.nr.1598/2025 të datës 06.10.2025, kishte hedhur poshtë si të parakohshme ankesën e ankuesve, të parashtruar me datë 14.08.2025, kundër heshtjes administrative të Komisionit për Kushtet e Tregut të Punës, në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ngase kishte konstatuar se ky i fundit, Kërkesën me numër protokolli 05-3903 të datës 22.05.2025, të Zv. Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë, për miratimin e Shtesave për Kushtet e Tregut të Punës në vlerën financiare prej 250 Euro, për ankuesit dhe Inspektorët Farmaceutik, e kishte pranuar vetëm me datë 24.07.2025.

Në rastin e lartë theksuar, Këshilli kishte konstatuar se ankesa e datës 14.08.2025, ishte e paraafatshme, ngase sipas shkresave të lëndës e njëjta kërkesë rezulton se nuk është deleguar paraprakisht tek organi kompetent, në këtë rast Komisioni për Kushtet e Tregut të Punës, përkatësisht ky komision të njëjtën kërkesë të datës 22.05.2025, e kishte pranuar me datë 24.07.2025, ndërsa ankuesit ende pa kaluar afati ligjor për përfundimin e procedurës administrative të iniciuar sipas kërkesës me numër protokolli 05-3903, kishin parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, gjegjësisht ende pa u përmbushur kriteri kohor lidhur me heshtjen administrative, ndaj kërkesës me numër protokolli 05-3903 të datës 22.05.2025, Zv. Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë, për përfshirjen e tyre në listën e përfituesve të shtesës për kushte të tregut të punës, për profesionistët shëndetësor të punësuar në administratën e shërbimit civil të Ministrisë së Shëndetësisë, dhe atë në shumën e shtesës prej dyqind e pesëdhjetë (250) euro në muaj.

Ankuesit, me datë 09.10.2025 kanë parashtruar ankesë në Këshill, kundër heshtjes administrative të Komisionit për Kushtet e Tregut të Punës, në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, në raport me kërkesën me numër protokolli 05-3903 të datës 22.05.2025, të cilët pretendojnë se plotësojnë të gjitha kriteret për përfitim të shtesës për kushte të tregut të punës prej 250 euro, sipas Rregullores (MFPT) Nr.02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës, ngase janë të emëruar si Specialist Shëndetësor dhe kanë të përfunduar studimet në fushën e shëndetësisë, duke poseduar tituj, si: Doktor të Mjekësisë, Magjistër të Farmacisë, Doktor të Stomatologjisë, Bsc.Infermierisë, Msc.Menaxhim Shëndetësor, Bsc.Mjekësi Sanitare, MSCI.PT, Bsc.Fizioterapi, Mp.Logopedi, njëjtë sikurse kolegët e tyre në Inspektoratin Shëndetësor, që gëzojnë shtesën në fjalë.

Andaj, si rrjedhojë e mos pranimit të asnjë përgjigje nga zyrtarët përgjegjës të cilëve i' u është dërguar kërkesa e protokolluar sipas procedurave ligjore, përkatësisht si pasojë e mos përditësimit të listës dhe mos kompensimit të shtesës në fjalë, ankuesit pretendojnë se janë duke u shkelur parimet themelore të Ligjit për Paga, përkatësisht parimi barazisë dhe mos-diskriminimit, dhe se në mbështetje të paragrafit 1 të nenit 100 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (akti administrativ i miratuar në heshtje), kërkojnë detyrimin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për kompensimin në mënyrë retroaktive të kësaj shtese dhe vendosjen që edhe në të ardhmen e njëjta t' iu ekzekutohet ankuesve.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesve të parashtruar kundër heshtjes administrative, nga shkresat e administruara të lëndës dhe thënieve si në ankesë, konstaton se ankuesit nuk kanë pranuar përgjigje/akt administrativ nga Komisioni për Kushte të Tregut të Punës/MFPT, ndaj Kërkesës me numër protokolli 05-3903 të datës 22.05.2025 (të pranuar me datë 24.07.2025), të Zv. Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë, lidhur me miratimin e Shtesave për Kushtet e Tregut të Punës në vlerën financiare prej 250 Euro, për ankuesit, kërkesë e proceduar në zbatim të Vendimeve të Këshillit me numër A.nr.88/2025 dhe A.nr.151/2025.

Andaj, Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me rregullat e veprimeve procedurale të një organi publik, i 'u referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *2. Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative, nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: 1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, nenit 97 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: 1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative; dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes, Kolegji i Këshillit konstatoi se Komisioni për Kushtet e Tregut të Punës në MFPT, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse ligjore, në raport me Kërkesën me numër protokolli 05-3903 të datës 22.05.2025 (të pranuar me datë 24.07.2025), të Zv. Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë, ngase sipas bazës ligjore si me sipër, vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurë administrative dhe manifestohet në formën e njërit prej veprimeve administrative, siç janë: akti administrativ; kontrata administrative apo akti real, dhe se në vlerësimin e Kolegjit, organi përkatës i punësimit, në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, është dashur që të nxjerr akt administrativ brenda një afati prej 45 ditësh sikurse përcaktohet me nenin 98 paragrafi 2 apo afatit të vazhduar sipas nenit 99 paragrafi 1 të LPPA-së, në kuptim të vendosjes dhe të njoftoj palën për aktin e tillë.*

Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, heshtja e organit të administratës, në këtë rast, Komisionit për Kushtet e Tregut të Punës në MFPT, në raport me Kërkesën me numër protokolli 05-3903 të datës 22.05.2025 (të pranuar me datë 24.07.2025), cenon të drejtat e ankuesve, ngase ashtu sikurse është thënë në arsyetim të këtij vendimi, në kërkesën e parashtruar tek Komisioni përkatës, nga Zv.Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, është kërkuar në mënyrë specifike të miratohet lista e Shtesës për Kushtet e Tregut të Punës në vlerën financiare prej 250 Euro, dhe se është obligim i këtij komisioni që në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi të nxjerrë akt administrativ dhe me aktin e tillë t'i njoftojë palët.

Kështu që thënë si me sipër e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj si të bazuar ankesën e datës 09.10.2025, dhe si rrjedhojë detyroj Komisionin për Kushtet e Tregut të Punës në MFPT, për shqyrtimin e Kërkesës së datës 22.05.2025 (të pranuar me datë 24.07.2025), brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimit, dhe të nxjerr akt administrativ në përputhshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegji.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1778/2025

Hava FEKAJ

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësueses së autorizuar të ankuesve, ankueses G.K;
- Komisionit për Kushtet e Tregut të Punës/ Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.